



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 02

Datë: 08. 04. 2019. Ora: 18:00

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë.

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Sami Hamiti, Florian Dushi, Adnan Rrustemi, Nazlije Bala, Ercan Spat, Stevan Veselinoviq, Alfred Kinolli, Cemajl Kurtish.

SKQZ: Enis Halimi, Kryeshef i SKQZ, Valmira Selmani (ZRPP).

Përkthyes: Vera Dula. **Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së.
 2. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore sipas Rregullës Zgjedhore nr.15/2013, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet Leptosaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen me datë 19 maj 2019.
 3. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e Sekretariatit.
 4. Të ndryshme.
-

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së

Valdete Daka: Përshëndetje. Kjo është mbledhja e dytë për këtë vit, dhe sic e dini, Presidenti me dekret ka shpallur zgjedhjet për kryetar të katër komunave: të Leptosaviqit, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Mitrovicës së Veriut. Këto zgjedhje, do të mbahen me 19 maj të këtij viti. Në këtë mbledhje, ne do t'i shqyrtojmë menjëherë dhe do të miratojmë disa aktivitete. Fillimisht, dua të ju pyes se, a pajtoheni me rendin e ditës...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës. Atëherë, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2.Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore sipas Rregullës Zgjedhore nr.15/2013, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në Komunat Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut, që do të mbahen me datë 19 maj 2019.

Valdete Daka: Sa i përketë pikës për caktimin e afateve caktimin e afateve të aktiviteteve zgjedhore, janë datat dhe afatet e aktiviteteve kryesore. Sipas ligjit, afatet duhet të shkurtohen sepse, këto i kemi zgjedhje të jashtëzakonshme! E dim që këto vendime janë marrë pa kaluar nëpër këshilla të KQZ-së, mirëpo edhe zgjedhjet janë shpallë sot, dhe ne nuk ishim në dijeni...Natyrisht, ne po tentojmë që ti marrim këto vendime urgjentisht, pra në përputhje me natyrën e tyre. A dikush vërejtje në këto aktivitete...?

Adnan Rrustemi: Me kërkesë të koordinatorit në drejtorit për Terren, te pika "1" në faqen e 2-të, sugjerohet se është përvjedhur një gabim teknik, dhe se vlerësojmë se jo "16 prilli" por "15 prilli" me qenë data e emërimit të Komisioneve Komunale Zgjedhore.

Në vazhdim të mbledhjes, kryetarja Daka, paraqiti përpara anëtarëve të KQZ-së, të gjitha afatet që interferojnë kohën prej 40 ditësh lidhur me organizimin dhe zbatimin e aktiviteteve që dalin si rezultat i këtyre zgjedhjeve:

Afati për krijimin e Listës së Votuesve, dhe periudha e kundërshtimit dhe konfirmimit, do të filloj me 3 maj, dhe do të përfundoj më 9 maj 2019.

Aplikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve, do të filloj me 9 prill, dhe do të përfundoj me datë 18 prill 2019.

Certifikimit dhe publikimi i subjekteve politike dhe kandidatëve, do të bëhet me datë 22 prill 2019.

Afati i fundit për tërheqje të kandidatëve nga shorti i fletëvotimit dhe afati i zëvendësimit të kandidatëve, do të jetë data 26 prill 2019.

Afati i shortit të Fletëvotimit, do të mbahet me datë 28 prill 2019.

Afati i fundit për të caktuar kufizimin e shpenzimeve për fushatë, është data 12 prill 2019.

Fushata zgjedhore si dhe afatet për tubimet zgjedhore, do të fillojnë me datë 13 maj, dhe do të përfundojnë me datë 17 maj 2019.

Dorëzimi i kërkesës për akreditimin e organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe vëzhgueseve, do të fillojë me datë 9 prill 2019, dhe do të përfundoj me datën 12 maj 2019.

Emërimet e Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve (KKZ), do të bëhen me datë 15 prill 2019.

Periudha e shërbimit të votuesve, do të fillojë me datë 23 prill, dhe do të përfundoj me datë 29 prill 2019.

Certifikimi i listës së votuesve, do të bëhet me datë 13 maj 2019. Emërimet e Këshillave të Vendvotimeve, do të fillojnë me datën 2 maj, dhe do të përfundojnë me datën 4 maj 2019.

Publikimi i Qendrave të Votimit, do të bëhet më datë 9 maj 2019.

Aplikimi për regjistrim si votues jashtë Kosovës, do të filloj me datë 25 prill, dhe do të përfundoj më datën 30 prill 2019.

Aplikimi për regjistrim si votues me nevoja të veçanta, do të filloj me datë 9 maj, dhe do të përfundoj me datë 13 maj 2019.

Caktimi i afateve sipas nenit I të këtij vendimi, do të vlejë për zgjedhjet e Jashtëzakonshme në Komunitat: Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Vendimit për zgjatjen e orarit të punës për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e Sekretariatit.

Valdete Daka: Tani, kalojmë në pikën tjetër që lidhet me zgjatjen e orarit të punës...! Zgjatja e orarit për anëtarët e KQZ-së dhe stafin e Sekretariatit, do të bëhet prej orës 08:00, deri në ora 18:00, çdo ditë kalendarike, deri në certifikimin e rezultateve përfundimtare nga KQZ.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan vendimin për zgjatjen e orarit të punës dhe, obligimet e tjera që dalin nga ky vendim.

4. Të ndryshme!

Adnan Rrustemi: Ne, sot e miratuam një vendim të përgjithshëm që shkurton afatet duke marrë në konsideratë faktin se janë zgjedhje të jashtëzakonshme. Mirëpo, në bazë të këtij vendimi, i mbetet Sekretariatit që ta përgatis një plan operacional të detajuar...Secili plan këtu, ka nënaktivitete të ndryshme, pastaj mbeten edhe resurset shtesë...

Valdete Daka: Po gjithsesi, jo vetëm kjo, por është edhe çështja e buxhetit shtesë. Në kontekst, urdhërohet sekretariati që ti fillojë menjëherë të gjitha përgatitjet e duhura...

Adnan Rrustemi: Kryetare, duke pas parasysh jo vetëm faktin e zgjedhjeve, por edhe për të qenë Sekretariati i funksionalizuar, duhet ta diskutojmë në mbledhjen e ardhshme edhe çështjen e "Kryeshefit", e për ti dhënë një epilog kësaj vështje...

Shpresoj që në mbledhjen e ardhshme, ta kemi këtë çështje në rend të ditës...

Valdete Daka: Po, do ta kemi këtë çështje në mbledhjen e ardhshme si pikë të rendit të ditës...